



Primar / Dorezuar Priljeva / Prodato Received / Delivery		08-01	2021	1	viti god year
Organ / Ijesta Organ / Jednica Org / Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtepja Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity		
SKPMSTICK	56/2021		114		



Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.381/2020

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës - Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj-Demi, kryetare, Arben Mehmeti dhe Eshref Shabani-anëtarë, me Rushit Kajtazi, Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën A.nr.381/2020 të datës 01.12.2020 të parashtruar nga ankuesja ██████████, me adresë Rr. "Ukshin Kovaqiça", Ndërtesa Urban Grup kati I, Nr.4, Komuna Vushtrrisë, kundër Vendimit me numër 1017/ 020 të datës 02.11.2020 të Kryetarit të Komunës së Vushtrrisë, në çështjen juridike "kontest nga marrëdhënia e punës", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjen e Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, të mbajtur me datë 08.01.2021, mori këtë:

V E N D I M

I. APROVOHET si e bazuar ankesa me numër A.nr.381/2020 të datës 01.12.2020, e parashtruar nga ankuesja ██████████

II. ANULOHET Vendimi me numër 1017/2020 të datës 02.11.2020 i Kryetarit të Komunës së Vushtrrisë.

III. OBLIGOHET Kryetari i Komunës së Vushtrrisë, që të bëjë zbatimin e këtij vendimi brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi, duke e kthyer ankuesen në pozitën e Drejtores së Qendrës për Punë dhe Mirëqenie Sociale", sipas Akt Emërimit të datës 03.11.2011, me të gjitha të drejtat dhe detyrimet nga marrëdhënia e punës, dhe të bëjë kompensimin e pagës nga dita e liritimit nga pozita e Drejtores së Qendrës për Punë dhe Mirëqenie deri në zbatimin e këtij vendimi.

IV. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

Ar sy e t i m

Ankuesja [REDACTED] përmes Vendimit Nr. 1017/2020 të datës 02.11.2020, të Kryetarit të Komunës së Vushtrrisë, është liruar nga pozita e Drejtores së Qendrës për Punë dhe Mirëqenie Sociale, duke u caktuar në pozitën e punës Zyrtare për Financa dhe Punë Administrative.

Kundër Vendimit me numër Nr. 1017/2020 të datës 02.11.2020, ankuesja brenda afatit ligjor, përmes postes ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, e cila ankesë është pranuar me datë 01.12.2020, e regjistruar me numër protokoll 2861/2020.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil më datë 03.12.2020, ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesën të Komuna e Vushtrrisë, ndërsa me datë 15.12.2020, Komuna e Vushtrrisë ka përcjell përgjigjen në ankesë së bashku më shkresat e lëndës.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave ka administruar këto prova: Ankesën A nr.381/2020 të datës 01.12.2020, me numër protokoll 2861/2020, drejtuar Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin e datës 02.11.2020, të Kryetarit të Komunës së Vushtrrisë; Akt Emërimit të datës 03.11.2011; kërkesën e datës 26.11.2020; Përshkrimin e Detyrave të Punës; Kontratën e punës e datës 16.01.2008; Kontrata e Punës 01.02.2010; Formuari për Vlerësimin e rezultateve në punë 01.01.2019; Formuari për Vlerësimin e rezultateve në punë 01.01.2018; Përgjigje në ankesë e datës 15.12.2020, me numër protokoll 3151/2020, me shkresat e bashkangjitura.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, për vendosjen e kësaj çështjeje ka shqyrtuar shkresat e lëndës të parashtruara nga palët, dhe ka konstatuar se ankesa e ankueses *është e bazuar, sepse:*

Bazuar në shkresat e lëndës përkatësisht sipas Akt Emërimit të datës 03.11.2011, Kolegji ka konstatuar se ankuesja është emëruar Drejtore e Qendrës për Punë dhe Mirëqenie Sociale, si staf i karrierës pa afat, e te cilën pozitë e ka ushtruar deri me datë 02.11.2020, përkatësisht deri në nxjerrjen e vendimit me numër 1017/2020 të Kryetari i Komunës së Vushtrrisë përmes të cilit ka liruar ankuesen nga pozita e Drejtores së Qendrës për Punë dhe Mirëqenie Sociale, për shkak të mos përmbushjes së detyrave të punës dhe performancës së dobët, mos respektimit të orarit të punës dhe dështimit në udhëheqjen e Qendrës për Punë dhe Mirëqenie Sociale si dhe ka caktuar ankuesen në pozitën Zyrtare për Financa dhe Punë Administrative, pozitë të cilën ankuesja e ka mbajtur para se të emërohet si Drejtore në Qendrën për Punë dhe Mirëqenie Sociale.

Parashtruesja e ankesës pretendon se Vendimi me numër 1017/2020 i datës 02.11.2020, është i kundërligjshëm për shkak të shkeljeve të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, Rregullores Nr.21/2020 Për Procedurat e Vlerësimit në Punë të Nëpunësve Civil dhe Nëpunësve të Shërbimeve Publike si dhe Ligjit Nr.03/L-149 Për Shërbimin Civil.

Nga Formulari i Vlerësimit të Rezultateve në Punë për vitin 2018, konstatohet se ankuesja është vlerësuar më notë të përgjithshme 2.3, ndërsa në vitin 2019, me notë vlerësimi 2.06.

Kolegji lidhur me vendosjen e ankesës, bazuar në Aktgjykimin Nr.KO203/19 me numër reference AGJ 1583/20 të datës 09.07.2020 të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, ka konstatuar se Ligji Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë është i zbatueshëm nga data 09.07.2020, dhe i njëjti, me dispozitat e nenit 32 paragrafi 3 ka përcaktuar, se: *Themelimi, ndryshimi apo përfundimi i*

marrëdhënies së punës në Shërbimin Civil bëhet vetëm sipas këtij ligji, ndërsa neni 85 ka shfuqizuar Ligjin Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil dhe çdo dispozitë tjetër në kundërshtim me këtë ligj.

Bazuar në dispozitat e Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, kolegji konstaton se marrëdhënia e punës në Shërbimin Civil është e përhershme (me afat të pacaktuar) ashtu siç është përcaktuar me nenin 32 paragrafi 2 i këtij ligji ku thuhet se: *3. Marrëdhënia e punës në Shërbimin Civil themelohet me aktin e emërimit dhe, përveç kur parashikohet ndryshe me këtë ligj, është e përhershme (me afat të pacaktuar), po ashtu edhe Ligji Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil, i cili ka qenë në fuqi në kohën e emërimit të ankueses në pozitën e Drejtores së Qendrës për Punë dhe Mirëqenie Sociale përkatësisht neni 19 paragrafi 2 ka përcaktuar se: Nëpunësit civilë në pozitat e karrierës pranojnë në punë pa afat..., në këtë kuptim Kolegji konstaton se pretendimi i ankueses është i bazuar.*

Kolegji duke vlerësuar ligjshmërinë e vendimit të atakuar me ankesë, ka analizuar nenin 61 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, i cili rregullon lirin nga Shërbimin Civil, duke përcaktuar se: *1. Marrëdhënia e punës në Shërbimin Civil përfundon me lirin nga Shërbimi Civil, në këto raste: 1.1. për shkak të refuzimit të pajustificuar të nëpunësit për të pranuar transferimin, sipas neneve 53 dhe 54 të këtij ligji; 1.2. kur nëpunësi deklarohet i paaftë për punë nga komisioni kompetent mjekësor, sipas ligjit; 1.3. pas dy vlerësimeve "jo kënaqshëm", për dy vjet radhazi, të rezultateve në punë; 1.4. kur nëpunësi ushtron të drejtën për pensionim të parakohshëm, sipas këtij ligji; 1.5. kur nëpunësi civil gjendet në një situatë të konfliktit të vazhdueshëm të interesit, të deklaruar nga vetë nëpunësi dhe, sipas ligjit, nuk merr masat e parashikuara për shmangien e konfliktit të interesit brenda afatit të përcaktuar apo nëse transferimi në një pozitë tjetër nuk do të mënjanonte gjendjen e konfliktit të vazhdueshëm të interesit; 1.6. kur nëpunësi i kategorisë së lartë drejtuese anëtarësohet në një parti politike ose kur nëpunësit e niveleve të tjera bëhen anëtarë të organeve drejtuese të një partie politike; 1.7. në çdo rast tjetër, të parashikuar me ligj. Në kuptim të këtyre dispozitave ligjore, Kolegji për vendosje të ankesës konstaton se liri është një nga mënyrat e ndërprerjes së marrëdhënies së punës në shërbim civil, e jo masë disiplinore ashtu siç është pretenduar me vendimin e Kryetarit të Komunes së Vushtrisë nr.1017/2020 të datës 02.11.2020.*

Përformanca e dobët në përmbushjen e detyrave të punës për dy vite radhazi, përben shkak ligjor për liri nga shërbimi civil ashtu siç përcaktohet me nenin 61 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, mirëpo nga shkresat e lëndës respektivisht sipas Formularëve të Vlerësimit të Rezultateve të Punës të ankueses, nota e vlerësimi për vitin 2018 është 2.3, kurse për vitin 2019 është 2.06, e të cilat vlerësime sipas nenit 11 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Rregullores Nr. 21/2020 Për Procedurat e Vlerësimit në Punë të Nëpunësve Civil, konsiderohen vlerësime "kënaqshëm ose mjaftueshëm ". Po ashtu Kolegji konsideron se mos përmbushja e detyrave të punës, jo profesionalizmi në përmbushjen e detyrave të punës, mos respektimi i orarit të punës, duke mos u regjistruar asnjëherë në ardhje dhe dalje nga puna si dhe dështimi në udhëheqje, përbejnë shkelje të detyrave të punës ashtu siç përcaktohet me nenin 46 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, mirëpo Kolegji vlerëson se këto shkelje të nëpunësit civil duhet të vërtetohen nga Komisioni Disiplinor në pajtim me dispozitat e nenit 45, 46, 47, 48, 49 dhe 50 të këtij ligji, dhe vetëm pas konstatimit të shkeljes duhet të shqiptohet masa disiplinore në raport me shkeljen e konstatuar.

Andaj, duke u bazuar në shkresat e lëndës, e meqenëse është konstatuar se ankuesi nuk posedon dy vlerësime jo të kënaqshme për dy vite radhazi nga mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë, po ashtu ndaj

ankuesit nuk është zhvilluar procedurë disiplinore lidhur me shkeljet e pretenduara në vendimin e kontestuar, Kolegji vlerëson se pretendimet ankimore të ankueses janë të bazuara.

Bazuar në këto rrethana, Kolegji për shqyrtimin e ankesës, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti Administrativ, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.381/2020

Rushit Kajtazi

Procesmbajtës

Ardita Haxhnikaj-Demi

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet

- Ankueses ██████████
- Kryetarit të Komunës së Vushtrrisë
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore të Komunës së Vushtrrisë; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.